REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 31.01.2025 Prot.32 (tridhjetëedy)

Protokoll nr. 32

I mbajtur sot më datë 31.01.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
4.P-V "Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Maliq për vitin 2025";
5. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2024";
6.P-V"Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit, për vitin 2025";
7. P-V "Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për familjet në nevojë, që do të trjatohen në Ndihmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2025";
8.P-V"Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përfitimin e Ndihmës Financiare dhe mbulimin e shpenzimeve të varrimit";
9-P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
10.P-V "Për vlersimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2026-2028";
11.P-V "Për miratimin e Deklaratës të Misionit dhe Vizionit të Bashkisë Maliq për peruidhën 2025-2029";
12.P-V "Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë";
13. P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim";
14.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
15.P-V "Mbi përdorimin e fondit për projektin "*Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi ndryshe*" me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq";
16.P-V "Për dhënie Tituj Nderi";
17.Raport lidhur me vendimarrjen dhe performancën e Këshillit Bashkiak Maliq për vitin 2024.
18.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Marainathi Avrami; Idlir Limllari; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Plator Çollaku; Enida Avdolli; Xhuana Hoxhallari; ;Eglantina Balli; Neresida Shindo; Marjeta Xhelollari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Dalina Krekas; Andonaq Risto; Faslli Zholi; 27(njëzetëeshtatë) këshilltarë.

Mungesa: Rovena Terolli; Ilia Xhuti; Almir Elezi; Klea Baçi; (katër).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Dërgjegjese e Sektorit të të Ardhurave; Alma Shkëlqimi; Përgjegjësi i zyrës të Rinisë; Endri Axhi.

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, ashtu sikur jeni njoftuar me rend dite prej 16 pikash, me rendin e dit ashtu sikur jeni njoftuar me rend dite prej 16 pikash, me rendin e ditës dhe materialet ju jeni njohur.Verifikojmë korumin, korumi realizohet, janë 26 Këshilltarë në sallë, mund të vijojmë.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Pranvera Begolli: Kam diçka Kryetar, te materialet kemi dhe një P-V për tituj nderi, që ti kemi të plota materialet, sepse ato shkojnë te Autoriteti i Dosjeve në Tiranë, them mos e shqyrtojmë sot por në një mbledhje tjetër.

Eglantina Balli:Përshëndetje të gjithëve! Në emër të grupit po marr fjalën, ne me rendin e ditës jemi kundra, sipas rregullores rendi i ditës duhet të përmbajë maksimumi 15 pika, ne kemi 18 pika, në Kryesi miratuam një rend dite paraprak dhe ishim dakord, por në materialet që na janë dërguar në email, rendi i ditës kishte 18 pika, nuk u pytëm më, nuk u miratua përsëri në Kryesi për këtë rend dite me 18 pika, u ndryshua dhe nuk u la me 13 pika.Kemi dhe një ankesë që gjithmonë e kemi prashtuar, nuk na janë marrë asnjëherë porpozimet që ne kemi propzuar për ti futur në rend dite, si për shemull, transparenca për ndihmën ekonomike, propozimet që kemi kërkaur për Titu Nderi, zgjedhjet për Kryetar fshati, Komisionet kemi kërkuar të funksionojnë, të shqyrtohen pikat para se të vijnë në mbledhje Këshilli, gjithmonë janë të njëjat kërkesa që kemi bërë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve!Nga ajo që pashë, shumica e pikave kanë të bëjnë me Këshillin, përjashtuar ato që kanë të bëjnë me ndihmat ekonomike, nuk do kisha asnjë problem që Komisioni përaktës, që mund të jetë ai përkrajes sociale, të vijë të shikojë, të bëjë një audit dhe të shohë se çfarë ndodh me dosjet e ndihmave ekonomike në çdo NJ.A, ne jemi të hapur, nuk kemi asgjë të fshehtë, ajo auditohet dhe nga Shërbimi Social Korçë dhe Drejrtoria e Shërbimit Social Kombëtar.Ju nëse kemi informacion më të detajuar me shkrim

për emra të caktuar, apo për dosje të caktuara, patjetër ne jemi të gatshëm, tja u vemë në dispoziocion, por nuk do isha darkord që ta kërkonit në parim, se parimi për 2400 familje nuk del, me pika të caktuara ne jemi të gatshëm për ta zhvilluar si proces.Në lidhje me titujt e nderit, unë kam qenë kundra, që ajo të diskutoheshe sot edhe pse ju e keni vendosur në rend dite, pasi kemi një detyrim ligjor, që për çdo titull nderi që japim, duhet ti kërkojmë mendim Autoritetit të Dosjve në Tiranë, për efekt që ligjvënsi e ka parë të arsyshme, ndaj dhe këtë kërkesë e kemi bërë si për emrat që keni në material ashtu dhe për ato që ka kërkuar opozita, që momentin e caktuar Komisioni të ketë dhe një dokument shtesë për këtë punë dhe e fundit do të kërkoja, ata që janë propozuesit për këto tituj nderi, duhet të jenë në mbledhjen e Komisionit që tju shpjegojnë dhe elementë të veçantë, për atë që ato kërkojnë se do ishte plus, mendoj që në përbërje të Komisionit të ketë dhe figura të veçanta, brenda apo jashtë bashkisë, të cilët mund të jenë profesorë, mësues historie, që ta marrim disa vendimarrje që ti rezistojnë kohës, nuk kam kundërshtim për asnjë emër si nga njëra anë dhe nga ana tjetër, qëllimi të vlersim dhe ata ta meritojnë atë që do ju japim. Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit!

Lulëzim Hoxhaj: Sa jemi këtu te Komisioni, unë nuk arrij ta kuptoj Komisioni që ka sjellë materialet, është Komision i Këshillit apo është një grup Këshillimor pranë Kryetarit të bashkisë ? Kur flasim për Komisione janë Komisione që ngrihen nga Bashkia dhe janë institucion i Këshillit Bashkiak.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky është një Komision që drejtohet nga Kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje, sipas vendimit që ka marrë Këshilli edhe përfaqësues nga ekzekutivi por dhe nga Këshilli i Bashkisë.

Lulëzim Hoxhaj: Ne i kemi miratuar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po keni përfaqësues nga Këshilli në këtë Komision.

Lulëzim Hoxhaj: Me sa kam djeni ky Komision, cili përbëhet nga 12 veta, nuk është hedhur për miratim, në mandatin që jemi ne.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Keni vendim Këshilli dhe ti mund të bësh pyetjen, kush nga opozita është pjesë e Komisionit.

Lulëzim Hoxhaj: Pse janë dy Komisone, është dhe Komisioni që drejtohet nga Floreta Zaçe, ti shkrimë të bëhet vetëm një Komision.

Faslli Zholi: Përshëndetje të gjithëve! Në emër të opozitës, nuk është hera e parë që ne kemi kërkaur të futen në agjendë disa gjëra, jo madhore por dhe madhore, ne i kemi kërkuar që të futen në rend dite, asnjëherë nuk na është marrë parasysh, ne si opozitë, pastaj aprovohet ose jo është tjetër gjë.Por të hidhen 13 pika dhe të bëhen 18, të konsultoheshin dhe pikat shtesë, e

para.Së dyti kërkuar gjithmonë, të mblidhen Komisionet para mbeldhjes, vetëm Komisioni i Financës mblidhet, ky është një mekanizëm që duhet ti shërbejë këtij Këshilli.Për sa i përket dekorimeve, ne kemi kohë që i kërkojmë, prandaj do ju lutem dhe ty si Kryetar dhe Kryesisë dhe Këshillit, ti hapin rrugë dhe opozitës, të futim në rend dite dhe ato që kemi ne.Kur bëhen punë të mira, do e them që është mire, kur nuk bëhet mire do them është keq.Rendi i ditës për ne është I kontestueshëm, sepse nuk është zbatuar rregullorja, që ju keni miratuar.

Ornildi Demollari: Dakord faleminderit! Për rendin e ditës, kemi paraqitur një rend dite paraprak, ashtu si e tha dhe Egla, mund të ketë zbritje dhe shtesa rendi i ditës, nëse heqim pikën e Titujve të Nderit dhe pikat e para shkojmë atje ku e lejon rregullorja.Megjithëatë ju keni të drejtën tuaj ta miratoni, ose jo.

Yllson Ibrahimllari:Për të mos e futur Këshillin në ngërç që në fillim, nga Kryetarja është lajmëruar, për sa i përket shkeljes të rregullores në nenin 66, pika 2, ku thuhet miratimi i jo më shumë se 15 pika në rendin e ditës, shpesh herë ne futemi në konflikt për ta zgjidhur, ti referohemi ligjit, rregullores, apo raporteve, unë besoj se nëse ka konsensus dhe nuk është çështja e miratojmë ju dhe pa votat tona, unë the ta kalojmë rendin e ditës, me këto gjëra, që Kryesia pavarsisht që nuk është ajo që miraton rendin e ditës, por është Këshilli Bashkika, ju sillni një projekt ide për rendin ditës, miratohet këtu dhe prandaj ne ngremë kartonat, nuk jam për të mos i dhënë opozitës hapësira, nuk jam që mos konsultohet dhe të mos merret asnjë mendim i opozitës, spespe kjo opozitë nga konstituimi deri tani, ka bërë propozime të cilat nuk janë vënë asnjëherë në rend të ditës.Tani që mos ngecemi në këtë ngërç, propozoj të vazhdojmë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Doktor ke bërë kërkesa të ndryshme dhe ne jemi përgjigjur në mbledhje, mos themi që nuk është marrë parasysh asnjë kërkesë.

Yllson Ibrahimllari: Po kam marrë përgjigje.Po flasim për pika të propozuara nga opozita për rendin e ditës, sepse ne ngatrohemi shpesh, ku përfundon Këshilli dhe ku fillon Bashkia.Kërkoj të rezervoj diskutim, për deri sa po e hiqini pikën e Titujve të Nderit, kërkoj fjalën për të sqaruar Komisionin e Këshilli dhe të Bashkisë, për ligjin.Kemi miratuar dhe në një mbledhje më parë Tituj Nderi për, do i nënshtrohen ata kriterit të Autoritetit të Dosjeve? Sepse kjo është pak diskriminuese, Dr.Kujtim Gora e ka marrë para pak vjetësh, tani mund ta marrë Dr.Enida dhe në këtë rast do e kemi verifikim dhe te rasti i parë jo.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër për rendin e ditës?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për sa i përket rendit të ditës, nuk mund ta quaj pikë të rendit të ditës, hapjen e mbledhjes, apo deklarimi i konfliktit të interesit, çfarë pike rendi dite është kjo? Mund të vendosni disa gjëra, pastaj të kaloni te rendi i ditës, apo pyetje dhe diskutime si pikë, nuk shkon kjo.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim rendin e ditës? Me një ndryshim duke hequr pikën 16, P-V "Për dhënie Tituj Nderi".

Yllson Ibrahimllari: Po keni konsensus.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 27 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 27 vota, miratohet rendi i ditës, duke hequr pikën 16,Faleminderit. Dua tju njoh dhe me vendimet e mbledhjes së kaluar janë gjithësej 14(katërmbëdhjetë) vendime, 9 (nëntë) janë me karkter (normativ) dhe 5 (pesë) me karkter individual ose kolektiv.

Ornildi Demollari: Ju ftoj të kalojmë në votim proceverablin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord ? 27 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 27 vota, Miratohet proceverabali, faleminderit! Dua tju kujtoj dhe konfliktin e interesit, nëse dikush nga ne ka konflikt interesi me pikat e rendit të ditës, nuk duhet të përfshihet në diskutime dhe në votim për atë pikë. Faleminderit! Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Maliq për vitin 2025"; Komisioni? Po.

Petrit Kupe: Shumë mirë që u disktua rendi i ditës dhe 3 pika kaluan shpjet, për mua numri 15 është i konsiderueshëm, kur ka dhe diskutime.Ne si Komisionin u mblodhëm dhe shqyrtuam këtë P-V, i cili synon të bëjë një shtesë në buxhetin e vitit 2025, për shakak të procedurave që ndodhin pas mbylljes të vitit, diferancat e krijuara janë për disa zëra të rëndësishëm, të cilat mbeten pa i përdorur nëse nuk bëjmë shtesë buxheti, ka ngelur transferta e pakushtëzuar 32 milon lekë, transferta specifike 32 milon lekë, buxheti i pavarur 21 milon lekë dhe të mbartuara 6 milon lekë, rreth 93 milon lekë.Ne i pamë dhe ajo që ka më shumë interes është përdorimi i tyre do bëhet vetëm brenda zëravc që kanë ngelur, nuk mund të kalojnë nga njëri te tjetri dhe Kryetari na sqaroi për detajimin e më tejshëm të shpenzimeve sipas zërave.Mendojmë se ky është një buxhet dhe konsiderueshëm gati 11 milon lekë, që i shtohet aktivitetit të bashkisë për vitin 2025, na pamë zërat dhe bëmë dhe sygjerimet tona dhe jemi dakord që sa më parë të miratohet, që të përfshihet në planin e vitit 2025.Kaq kisha faliminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Opozita kemi diçka tjetër?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po shpjegoj disa zëra të buxhetit në të përgjithshme, pastaj pyetje dhe diskutime nuk kam asnjë problem.Buxheti i bashkisë shtesë i 2025, është një buxhet shumë i rëndësishëm, me një vlerë të konsiderueshme, me një vlerë 93.247 milon lekë dhe, ana pozitive e këtij buxheti është, se mbi 50% kalojnë për investime dhe pjesa tjetër 43%

janë shpenzime operative, jemi të detyruar për përdorimin e fondeve pasi një pjesë e fondeve, janë fonde specifike dhe nuk mund ti lëvzim nga njëra strukturë buxhetore tek të tjerat, por do ti lemë përsër atje, për të përmbyllur ato çkanë nevojë institucionet përaktëse, sipas pasqyrës, informacionit që ne ju kemi përcjellë. por dhe sipas P-V, në totalin e përgjithshëm transferta specifike kap 32 milon 889 mijë lekë, ku pjesën më të madhe e kap arsimi parshkollor, rreth 18 milon lekë, Ujitje-Kullim rreth 11 milon lekë dhe këto fonde janë detajuar për shpenzime operative po në këto struktura buxhetore të cilat mbulojnë zëra të rëndësishëm të cilat ne i kemi në proces apo të parshikura si shpenzime të reja buxhetore.Po ta shikoni pasqyrën kemi përmbyllur atë shqetësimin që kishin Këshilltarët në buxhetin fillestar për arsimin, për ngrohje, për Pellet, dru zjarri, për gaz të gjitha fondet kanë kaluar atje dhe ka ngelur dhe një fond 4 milon lekë 5.557, cili do kalojë për reabilitim objekte, terrene sportive në shkolla dhe për fondet e Arsimit të Mesëm të cilat kalojnë te 602 për ngrohje, apo edhe për struktruat e reja buxhetore, si Shërbimi Zjarrëfiksës, Ujitje-Kullim, Pyje-Kullota, Rrugë, Shërbim Publik etj.Në zërin paga këtu kemi një vlerë të vogël rreth 55 milon lekë për plotësime, por brenda strukturave buxhetore, në investimet e prapamebetura po të shikoni ne kemi parshikuar fonde dhe për projekte, blerje pompash, rikonstruksion Qendra Kulturore Maliq, janë të prapmbatura nga një vit më parë, të palikujduar, nuk janë përmbyllur investimet.Në investimet e reja kemi futur tre projkete, shkolla Sheqeras, reabilitim i të gjithë pallateve në bashkinë e Maliqit, të kemi një projket për sistemin kapot dhe për çatitë, kudo ku kemi pallate të kemi një projket të mirë për financim dhe duam të ngremë një Park të madh lojrash në Maliq, atje ku kanë qenë kanalet e Panxharit, që nuk do shërbejë vetëm Maliqit, por gjithë zonës.Reabilitim terrene, objekte shkollore 5.5 milon lekë, për herë të parë futim dhe asfaltimin e rreugës të Kolanecit dhe të Zvezdës, sepse në datën 9 Shkurt bëhet tenderimi për Ujësjellsin e fshatit, ku nd duhet ti paraprijmë dhe të ndërhyjmë me asfaltimin e rrugve të brendshme të këtij fshati, pasi nuk kemi ndërhyrë pasi e kemi lënë të mbyllet Ujësjellsi dhe pastaj, në këtë pikë kemi futur dhe një projket të tillë, i cili besojmë do të mirpritet në fshat.Veshje zjarr duruese për Shërbimin Zjarrëfikës me fondet e tyre, investime në proeces, kërkojmë të Bob-Cat me fondet e Ambasadës Japoneze, nuk janë fondet tona, por mbahen në llogari, rreth 6 milon lekë të reja, është një fond për pastrim kullote nga Tap, blerje vegla muzikore janë fonde që nuk janë tonat por janë të mbartuara nga viti i kaluar.Në shpezimet ju kemi shpjeguar, por janë vlera të vogla, në totalin e përgjithshëm ky buxhet kap invesitme 50 milon 150 mijë lekë dhe shpezime operative 42.877 lekë, nëse ka pyetje me të hollësishme jam gati tja u shpjegoj dhe zë më zë sipas tabelës, që ne kemi hartaur për këtë qëllim.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër te pika 4? Po.

Yllson Ibrahimllari:Në P-V Për miratimin e buxhetit shtesë të vitit 2025, vemë re që te transfertat e pakushtëzura, te pjesët e mbartura të kapitalit etj, është bërë ajo që ne kishim vëretje në buxhetin që kaluam në muajin Dhjetor, por sigurisht ju shpesh na thoni mos e beni politike dhe nuk po bëjmë politike, është mirë kur publikoni mbledhjet e Këshillit, është mirë mos nxirini opozitën e me kartona jeshilë, sepse ka dhe foto me kartona të kuq. Do doja që në një nga

mbledhjet e ardheshme të kishim më shumë detaje të projektit nga Ambasada Japoneze, ju keni bërë një marrveshje dhe sigurisht kjo do jetë goxha fitim prurese për Rrugët Rurale, do doja një detajim, sa më konçsi për këtë.Pjesët e tjera i kemi kaluar.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

E kalojmë në votim pikën 4 ?

Kush është dakord ? 27 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 27 vota, miratohet.Faleminderit.Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2024";

Neresida Shindo:Përshëndetje! Ne si Komisioni i Mirëqënies Sociale jemi mbledhur dy ditë para mbledhjes së Këshillit, për herë të parë në këto dy vjet ne kemi bërë një mbledhje Komisioni ashtu si duhet, me raporte dhe procesverbale të mbajtura, kështu duhet të jetë çdo Komision, të mblidhet një ose dy ditë para mbledhjes të Këshillit.Në familjet që përfitojnë Ndihmë Ekonomike ka shumë familje që e përfitojnë, por kemi hasur disa indicje nga disa qytetarë, që ka edhe disa familje, që ngre dyshime mos jetë e drejtë kjo ndihmë, për arsye se janë tre familje që unë ja kam paraqitur Ermandës ti verifikonte, prshembull ka pensionistë jetojnë vetëm kanë fëmijët jashtë, pse e përiton një dhe jo një tjetër, ka raste të tjera janë me Kemp marrin dhe Ndihmë Ekonomike, ka të tjerë që e kanë lejën e banimit atje, por jetojnë në vend tjetër.Faleminderit!

Pranvera Begolli: Ne kriteret për Ndihmë Ekonomike i dimë, por ka një rast e z.E.D, guran e ka të paralizuar shkon paraqitet pranë Ndihmës Ekonomike, por procedurat e vonojnë të shkosh në Korçë, kush do i shërbejë asaj gruaje? Kur ai është i vetëm, si mund ta ndihmojmë Ermanda atë person? Kur një fëmijë shkëputuet nga familja, krijon familje të re, pse i ndërpritet Ndihma Ekonomike? Një familje që jeton në bllokun nr.3 Maliq dhe merr Ndihmën Ekonomike në Maliq.Pse penalizohet familja?

Faslli Zholi:Këtu te Ndihmat Ekonomike, sipas materialve që ne kemi para ne shikojmë, që ka individë, familje, të cilët nuk e kanë meritaur në bazë të kritereve, ndaj kërkuam të shpallen Ndihmat Ekonomike, në fshatrat më me zë, me qëllim që kjo punë të shuhet, sepese jam plotësisht dakord me atë që thotë Vera që ka të sëmurë dhe mos e marrë dikush që vjen vërdallë dhe nuk punon ose dikush që nuk është fare këtu.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Ermanda ke tre komnete nga Kryetarja e Komisionit, je njohur?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po patjetër, i kemi diskutuar në mbledhje Komisioni.Për sa i përket familjeve që janë diskutuar në Komision kemi bërë një verifikim ditën e djeshme dhe janë familje që jetojnë në territorin e bashkisë Maliq, jetojnë në banesa, ku njërën

prej tyre kemi kryer dhe restaurimin e çatisë dhe këto janë të treja familje që jetojnë në territotin e bashkisë Maliq, përveç pjesës ku njëra nga familjet kishte dy anëtarë pensionistë në kushte shumë të vështira ekonomike, banesa të bërë me blloqe dhe ata jetonin atje, përveç problemeve shëndetësore të tjera që kishin, familja tjetër ishte, që kryefamiljari është me aftësi të kufizuar dhe kjo nuk e pengon familjen të aplikojë për Ndihmë Ekonomike dhe të përfitojë nga masa e Ndihmës Ekonomike.Kjo familje jeton në territorin e bashkisë Maliq, është verifikuar dje në mënyrë rastësore, pa njoftim që do shkonim atje dhe duket që familja jetonte në atë banesë, e cila ishte dhe restauruar nga ana e bashkisë dhe personi tjetër, është një e moshuar që jeton vetëm, përveç kësaj zonja është përfshirë në fondin 6%, sepse ka probleme të mëdha shënetësore, duke patur Epilepsi kornike dhe sëmundje të tjera shoqëruese, për këtë arsye është përfshirë në fondin 6%.Për sa i përket rastit që tha zonja Vera, Istref Dulillari, po është një rast që është paraqitur pranë zyrës tonë, duke bërë kërkesën për Ndihmë Ekonomike, nuk duhet të shkojë në asnjë vend, vetëm duhet të marrë një vërtetim toke në Moglicë dhe të rregjistrohet si punë kërkues te zyra e punës, cili është një nga kushtet për të përfituar Ndihmën Eknomike.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Çfarë vertetim duhet?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Vëretetim që ka përfituar tokë nga NJ.A Moglicë, vërtetimin e kemi zgjidhur me Administratorin, por problemi i zotërisë, është punësimi kur paraqitet te zyra e punës, i ofrojnë dhe ata ndoshta nuk janë dakord për shkak të kushteve dhe kjo nuk i përket zyrës të Shërbimit Social.Për sa i përket ndarjes nga certfikata familjare, me të drejtën e tyre pasi mbushin 18 vjet, ligji i gjendjes civile e njeh si të drejtë e çdo individi për tu ndarë, ndërsa ligji i Ndihmës Eknomike e ka të përcaktaur qartë, që të gjitha familjet ose fëmijët ndahen nga certfikata familjareme të njetën adresë banimi, quhet ndarje me qëllim përfitimi dhe e deklaron ose jo penalizohesh për një periudhë 6 mujore nga Ndihma Ekonomike.

Ornildi Demollari: Po Nersida.

Pranvera Begolli: Duhet të mbetet pa Ndihmë Ekonomike sepse ndahet nga familja?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Ka raste të tjera që familja po ndahet nga certfikata familjare, si prsh blerja e një automjeti, i cili është në emër të djalit, ka një arsye që familja ndahet.

Neresida Shindo: Si përfundim dhe ti vemë një përkufizim, të gjithë pensionistët që përfitojnë nga fondi 6%, duhet të kenë sëmundje të rënda të dokumentuara, ashtu si përmbajnë protokollet e mjeksisë, që jo çdo pensionist i vetmuar mund ta përfitojë, që mos aludojnë që dhe ne jemi pensionitë të vetmuar me fëmijë jashtë dhe mund të marrim dhe ne, atëherë duhet të ketë dhe një sëmundje të rënda, jo sëmundje kronike.Faleminderit!

Faslli Zholi:Për Ndihmën Ekonomike, jam të bëjmë kontroll se ne për këtë i jemi referuar Prokurorisë dhe presim përgjigje, spese ka fenomene që ne i shohim në çdo fshat, na i thonë qytetarët, pse i përfiton dhe ai jo. Faleminderit!

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Në mbështejte të fjalës të Kryetarit, si drejtuese Shërbimit Social pranë bashkisë Maliq, jam e gatshme të bashkpunoj që ne të kryejmë një Auditim në çdo NJ.A dhe për ti parë rast pas rasti problematikat që ju paraqisini, por duke i verifikuar që kanë vërtet shkelje apo mos përputhje me kriteret që parshikon ligji.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, se duket se vazhdimisht po paraqitim të njëjtën gjë, jemi përballë një fakti që varfëria nuk ka ngjyrë.Po falsim për një rast që znj.Vera e ngrit këtu, thotë që znj është e paralizuar, ku znj është e paralizuar, çfarë pune mund të kërkojë bashkëshorti? Bashkëshorti përfiton paketën higjenike automatikisht, që i shërben zonjës të vetë.Mendoj që këto raste znj.Ermanda apo Sektori i Bashkisë që i ka, kemi dhe një Komision Shëndetësie në Këshillin Bashkiak, për rsate që vërtet kanë ndërdhurje midis të dyjave, të dalim me konkluzione dhe mos garojmë njëri tjetrin, kush do marri rradhën për të folur më bukur, ose ndoshta le të krijohet një Komision miks, midis Ekonomisë dhe punonjësve Sociale dhe Mjekve që ka këtu, ne kemi dy Mjekë këtu në Këshilli dhe Infermier po ashtu, mund të japim një ndikushmëri, kush e ka kush nuk e ka, mund të thërasim Përgjegjsin e Punve Sociale në bashkinë Maliq, apo të Qarkut si është hieriarikia, mund të thrasim dhe Doktorin këtu që jep PAK edhe të dalim me një konkluzion dhe ti themi.Për mendimin e Opozitës të gjitha e listat e 6% janë politike, për mendimin e Pozitës të kësaj bashkie janë të drejta, të bazuara në ligj dhe kjo është një çështje që ne nuk e mbyllim kurrë, nëse ne do arijmë të nximtim programe lokale, të këtij lloj niveli, që ta ulim sa më shumë, numrin e atyre që marrin dhe në qoftë se Kryetari, ja arrin këtij qëllimi ta kemi zhdukur në mandatin tonë, do ishte gjë shumë e mirë.

Ornildi Demollari: Yllson faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të ndërhyj një moment? Jam shumë dakord me Doktorin, po ti hyjmë Ndihmës Ekonomike, asnjëhere nuk plotësojmë ato çka komuniteti kërkon, pasi çfarë ndodh? Skema 6% nuk i vendosim ne, ato janë familje të cilat, janë në skemë por dalin me pikë të pamjatueshme, a ka vend për emra se kush e përfitoj? Kjo le vend për tu diskutuar.Këshilli i Bashkisë, ka një të drejtë të informohet, jo të bëjë Auditit, ka Institucione të tjera që e bëjnë, por Këshilli ka të drejtë të informohet, për një Dosje të caktuar, apo emër, për të marrë shpjegimet ligjore, këtë të drejtë nuk ja hqeim dhe një qytetari.Jemi të hapur për këtë punë, nëse doni informacion për 100 dosje, na i parqisni dhe ne t'ju sjellim inforamcion, ska problem dhe nëzyra mund të vini nëse doni, ata dhe unë mbajmë përgjegjsë ligjore, për çdo vendimarrje që marrim apo që ju propozojmë ju.Njerzit janë mësuar keq dhe me Ndihmën Ekonomike, jemi të vetëdijshëm për këtë punë.

Pranvera Begolli: Flasim për një person, që të marrë Ndihmë Eknomike dhe të jetë pranë gruas.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk mund ta bëjmë mbledhjen e Këshillit me emra konkretë, në mbledhje Këshilli flitet për parime, flitet si mund të zgjidhet ky problem.A ke ti një zgjidhje si anatare e Këshillitq që mund ta ndihmosh? Zotëria përfiton dhe paketën Higjenike.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Personat që janë kujdestarë të një personi Prara dhe Tetraplegjik, përveç pagesës të kujdestarisë, përfitojnë dhe vjetërsi pune për vitet që I shërbejnë të sëmurit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po rasti në fjalë e përfiton?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po është komisionuar muajin e fundit, po besoj se po do e përfitojë, spepse dhe mjeksia ka procedurën e saj, sa të dalë masa e përfitimt në bazë të diagnozës, ka një Komisioni për këtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nëse Këshilltarët, kanë raste si ky, të shkojnë te Ermanda dhe ta shohin si është rasti.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër?

E kalojmë në votim pikën 5?

Kush është dakord me pikën 5? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet,Faleminderit.Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bilok Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit, për vitin 2025"; Miratimin e kritereve dhe procedurave, Po.
Neresida Shindo: Kriteret ne i pamë në Komision.
Faslli Zholi:Për kriteret jemi shumë dakord, por vetëm duhet të zbatohen.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Duke qenë se ju i miratoni kriteret, kur vjen lista i thoni Ermandës pa 16 pa emër nuk i plotëson kriteret dhe i plotëson diksush që nuk është në listë.
Ornildi Demollari: Kemi diçka tjetër Nersisda?

Neresida Shindo: Jemi dakord me kriteret, sepse janë të vendosuara nga VKM-ja, vetëm të zbatohen si duhet.

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim pikën 6?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pika 6 ,Faleminderit.Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për familjet në nevojë, që do të trjatohen në Ndihmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2025";

Neresida Shindo: Ky fond me sa kuptova nuk do jetë nga Ministria dhe pyeta, nëse ka familje që e përfitojnë? Por Ermdanda më tha që nuk kemi familje deri tani të rregjistruara.
Ornildi Demollari: Faleminderit! E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pika 7, Faleminderit.Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës, P-V"Për miratimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit, për përfitimin e Ndihmës Financiare dhe mbulimin e shpenzimeve të varrimit";
Neresida Shindo: Kjo pikë nuk ka diskutim, e miratojmë.
Ornildi Demollari: E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pika 8, Faleminderit.Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"; Kryetar ke diçka këtu?
Neresida Shindo: Kam një familje për të shtuar këtu, ja kam propozuar Ermandës.
Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Janë dy familje dhe një që është propozuar në Komisionin dhe shumë mirë që kemi bashkëpunimin e Kryetares të Komisionit, duke referuar dhe raste që duhen mbështetur, nga verifikimi që ne kemi kryer është një zotëri, i cili ka patur probleme të mëdha shëndetësore vetë dhe djali i tij, për momentin djali është në gjendje të mirë shëndetësore, ndërsa zotëria ka probleme fizike duke mos lëvizur nga gjymtyrët e tij, gjithashtu dhe zonja ka probleme të rëna shëndetësore, është menduar që familja e zotërisë të mbështet me një ndihmë financiare, ndoshta simbolie për ti ardhur në ndihmë.
Neresida Shindo:Bëhet fjalë për rastin që ka dalë dhe në media, që i ka marrë makina zjarr dhe u dogjën të dy babë e bir në makinë, për fat të mirë djali nuk ka probleme, ndërsa kryefamiljari dorën e ka jashtë funksionit, bashkëshortja vuan nga një sëmundje e rëndë, gjendjen e ekonomike nuk e ka të mirë të përballojë këto shpenzime, kështu ne mund ti vijmë në ndihmë sa do pak.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ke ndonjë propozim për vlerën?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Vlera me përafërsi 30.000 lekë s itë gjithë, që të kemi mundësi ta mbështetim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk kam asnjë kundërshtim, ta diskutojmë me financën për shumën.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pika 9, Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ermanda, kemi dhe një rast në fshatin gjyras, ka sëmundje ta shohim, jo në këto nivele.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po bëhet fjalë për një zotëri nga fshati Gjyras që ka probleme shëndëtësore.

Yllson Ibrahimllari:Për çdo rast të ngjashëm si ky, si për zjarre dhe për fatkeqësi të tjera , kemi thënë që në çdo kohë një mbledhje onilne, votën tonë e keni pro.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim me ndryshimin e pare dhe duke shtaur dhe rastin e fshatit Gjyras?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pika 9, Falcminderit.Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës. P-V "Për vlersimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2026-2028"; Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo është një procedurë standarte, ashtu si e keni parë, këtë shqetësim ma ngritën dhe në Komisionin e Financave, që është i njëjti material nga vjet, apo si qëndron? Në faket nuk është i njëjti material, por është një detyrim ligjor që ne shifrat, nga një vit buxhetor nga të ardhurat i hedhim se ashtu e përcakton dhe ndryshojmë vetëm kur vijnë tavanet buxhtore nga njëri vit në tjetrin, duke shtuar transfertë me %, të përcaktuar me VKM, për të përcaktuar një buxhet ndër vite, pastaj ajo do ketë vendimarrje nga Këshilli i Bashkisë, apo situata që ne kalojmë.Është një procedurë standarte, do doja ta kalonim.

Yllson Ibrahimllari: Duhet tju gëzojë ky fakt, sepse tregon që Këshilltarët e kanë lexuar atë që kanë votuar vitin e kaluar.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim?

Kush është dakord ? 25 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 25 vota, miratohet me 25 vota , Falcminderit.Kalojmë te pika 11 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Deklaratës të Misionit dhe Vizionit të Bashkisë Maliq për peruidhën 2025-2029"; Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe ky është një moment i rëndësishëm për ne, në çdo rast le vend për gjykim, diskutim, për shtesa, pakësime do isha i hapur, jo vetëm sot por dhe në ditët në vazhdim, deri sa ta zbardhim, por e kemi detyrim ligjor për ta sjellë.Hedhim disa ide, një vizion, duke u mbështetur dhe në Planin e Përgjithshëm Vendor por dhe në dokumenta të tjerë që bashkia jonë i ka për efekt të zhvillimit bujëqsisë, të turizimit, blektorisë, apo të infrastrukturës

në të gjitha fushat, kështu që në këtë aspket ne ju kemi përgatitur një material, duke marrë në konsideratë dhe ato çfarë, bashkia ka patur ndër vite, ato që janë përmbyllur dhe ato që janë ende pa mbyllur, pasi nuk do të thotë qëato realizohen në kohë në të gjitha pikat që ne përcaktojmë.Kemi përcaktuar dhe funksionet dhe objektivat në aktër vite edhe vetë misionin e bashkisë, duke përcaktuar faktorë të ndryshëm, në fushën e infrastrukturës, shërbimve sociale, kulturë, sport, mjedisin.Kemi bërë një gjithë përfshirje, të ligjit që pusteti lokal përcakton për efeket të kompetencave dhe detyrave që ka pusheti lokal, për çdo rast ka vend për tu diskutar, për të marrë mendime dhe jemi të hapur për këtë pjesë edhe nga Këshilli i Bashkisë, nga të gjitha grupet pa përjashtim, nuk lidhje pjesa politike. me idenë që ky material të jetë sa më i plotë dhe të sjellë një inforamcion sa më saktë të gjendjes dhe asja ku ne synojmë të arijmë.Shumë faleminderit!Jam mundur të përfshi gjithë elemenetët, ka eksperienca dhe të bashkive të tjera që ne i marrim si modele, por e sjellim në kushtet konkrete të bashkisë ku ne jetojmë.

Ornildi Demollari: Kryetar faleminderit! Kemi diçka këtu? Opozita, Egla? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 25 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 25 vota, miratohet me 25 vota pika 11, Faleminderit.Kalojmë te pika 12 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë";

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kjo është hera e parë që sjellim një Plan s ky, nuk e di nëse ka pyetje dhe Endrin e kam këtu, si përjgegjës që mbulon rininë në bashki.Dhe ky është një detyrm ligjor, në kuadër dhe të Ministrisë përaktëse që mbulon rininë, janë hartaur këto plane dhe ne duam të përfshihemi në këto plane dhe për të përfituar projekte dhe për të patur disa vizione më të mira, për të rinjtë, nxënsit e shkollave , por jo vetëm në shkolla, por dhe kudo në komunitetet tona, me Qendra Rinore, për të cilat duhet një plan i tillë, pastaj duhet të hartohen projkete për të kërkuar financime, jo vetëm nga bxheti i shtetit, por dhe nga doantorë.Vendimarrja që Këshilli merr në raste të tilla, është shumë e rëndësishme, është një nga detyrimet ligjore, kur ka dhe një vendimarrje nha Këshilli i Bashkiak, nuk e di a e keni parë materialin, por besoj është i përgjithshëm për të bërë të mundur që të kemi dhe ne atje prioritet tona për rininë dhe për të rinjtë edhe kjo patjetër kërkon fonde, buxhete për ta realizuar dhe për tu bërë gjithë përfshirës në realzimin e këtyre projekteve.

Ornildi Demollari: Faleminderit kryetar!

Yllson Ibrahimllari:Në këtë kuadër, do doja që znj.Drabo është këtu, zotëria që merret me rininë dhe Gerti, të na bëjnë një projket dhe unë do e negocjoj me Ambasadën Franceze për një Qendër Rinore në bashkinë e Maliqit, kur të keni projketin gati më thoni.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër? Endri?

Përgjegjësi i zyrës të Rinisë; Endri Axhi:Në material është shpjeguar pothuaj se e gjitha, nëse ka ndonjë pyetje? Ky është një plan që është hartaur nga bashkia Maliq, në bashkëpunim me Qendrën e të Drejtave të Fëmijve në Shqipër idhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë, është një infrastrukturë ligjore, e cila i hap rrugë të rinjve për të kërkuar dhe për tu angazhuar dhe në politikë, për ti dhënë të drejtat e tyre për të shperehur dhe pse jo për të patur projektet e tyre dhe ne kemi më të lehtë, duke patur këtë infrastrukturë ligjore.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pro,faleminderit! Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim"; Po Idlir.

Idlir Limllari:Bëhet fjalë për familjen që ju dogj banesa në fshatin Vloçisht dhe përfiton nga ligji për Strehimin Social, familja është strehuar në një shtëpi me qira, bashkia do paguajë qiranë për një vit 75.000 lekë për një vit deri sa të rregullojë shtëpinë, nuk ka ndonjë gjë ta kalojmë.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pro,faleminderit! Kalojmë te pika 14 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
Idlir Limllari: Dhe kjo është një familje, një grua kryefamiljare, personi përfiton nga kjo, i është miratuar kredia, ka akoma gjendja, ajo që diskutuam dhe herën e kaluar, mendoj të miratohet, fondet janë të Ministrisë.
Ornildi Demollari: Faleminderit! Kemi diçka tjetër? Ka nevojë për shpjegim? Kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk ka shpjegim, por kam një aplel dhe persona të tjerë të cilët duan ta përfitojnë, të paraqiten të kërkojnë dokumenta dhe ne jemi të gatshëm që bazuar në këtë program ti ndihmojmë, është një lehetësi shumë e madhe për ata që e përfitojnë këtë status.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim ?

Kush është dakord ? 26 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 26 vota, miratohet me 26 vota pro piak 14 e rendit të ditës,faleminderit! Kalojmë te pika 15 e rendit të ditës, P-V "Mbi përdorimin e fondit për projektin "*Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi ndryshe*" me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq";
Neresida Shindo: Mund të shtij diçka këtu?

Ornildi Demollari: Po.

Neresida Shindo: Do doja një sqarim më të detajuar, sepse shikoj këtu në aktiviteti njp punonjës, e kam të pa qartë se çfarë do bëjë ky punonjësi, do bëjë dhe Psikolugun? Higjenizmi për persona me aftësi të kufizuar, do ti shërbejë me ushqime? Me shëtitje? Nuk e kuptoj këtë.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Për sa i përket nga fondi Social, ky është financimi i vitit të tretë nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Shëndetësisë, kemi 30% të mbulimit të fondit total të projektit, duke qenë se vitet e kaluara ne kemi patur dhe staf tjetër mbështetës, supozohet që këto familje që kanë një periudhë dy vjeçare, që mbështeten em psikolog, me kujdestar për krijimin e kushteve higjeno sanitare, tanimë kanë marrë kulturën e tyre për të vijuar vetë punët në vazhdimësi në banesë, me gjithë atë përveç Koordinatorit e cili do të bëjë dhe shpërndarjen e materialeve, paketave higjeno sanitare, mbështejen për orientim të tyre për shërbimit që ofrohen në bashki, por jo vetëga OJF të ndryshme, janë dhe punonjësit social të NJ.A, të cilët do jenë në mbështetje të këtij Koordinatori.

Neresida Shindo:E kam të pa qartë te tabela që thotë, vetëm një punonjës, do ketë dhe punonjës të tjerë?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Ky është një fond i cili vjen përcaktuar nga Ministria dhe ky fond është për një punonjës nga ana e Minsitrisë, pastaj kemi dhe ne punonjësit tanë të bashkisë, ky është miratimi i fondit vetëm për pjesën e Minsitrisë së Shëndetësisë.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kryetar kishe diçka? E kalojmë në votim ?

Kush është dakord me pikën 15 ? 25 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 25 vota, miratohet me 25 vota pro pika 15,faleminderit!Në radhë është pika 16, Për dhënie Tituj Nderi, për të cilën dakortësuam, ta hiqnim nga rendi i ditës, mbase t"ju rikujtoj sërisht që për të gjithë emrat e propzuar Për dhënie Tituj Nderi, ne jemi drejtuar Autoritetit të Dosjeve, për verfikimin e pastërtisë të figurës dhe sapo të na kthejnë përgjigje ata, do të zhvillohet mbledhja e Komisionit të dhënies të titujve dhe besoj në një mbledhje të radhës të Këshillit do vijnë të gjithë, në vartësi të përgjigjes që do na vijë nga Autoritetit i Dosjeve.Kështu që j ufalenderoj për mirkutimin.Kalojmë te pika 17 e rendit të ditës, që është, raport lidhur me vendimarrjen dhe performancën e Këshillit Bashkiak Maliq për vitin 2024.Kalojmë te piak tjetër e rendit të ditës, Diskutime të tjera.Pstaj do e përcjell raportin e performancës.Yllson janë dy qyetarë, pastaj mund të vazhdosh.Zotëri po.

Qyetari z.Biba: Jetoj në fshatin Drithas, problemi im është rregullimi i çatisë të shtëpisë nga projektet që ka fituar bashkia, banesa ime çatinë e ka të përbërë nga materiali Internit, sipas ekpsertve të fushës, është e pa banueshme për ne dhe komshinjtë, sepese ky materail është i dëmshëm, afër banesës time është dhe shkolla.
Ornildi Demollari: Ajo është banesa juaj? Nuk ke patur mundësi ta riparosh?

Qyetari: Jo nuk kam patur, nga bashkia në Drtihas janë ndihmuar shumë familje, të më ndihmoni dhe mua si këto familje.

Idlir Limllari: Internitet nuk janë të rrezikshme, në momentin që kthehen në pluhur po, kanë probleme në mushkri.Por të shihet mundësi të ndihmohet.

Faslli Zholi: Problemin e qyetarit, unë e kam ngritur disa herë dhe me Kryetarin kam folur personalisht dhe në dëgjesa e kam ngritur, më është thënë që duhet e bërë, unë nuk e dija që ishte me Internit. duhet bërë nëse është mundësia.Për mua është neglizhencë ky rast.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Kryetar ke diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për çdo rast ne duhet të zbatojmë ligjin, ndaj dhe ne po kërkojmë të jemi në rregull dhe me qyetarin, por dhe me ligjin.

Faslli Zholi: Po të shohim atje ka diferencime, dikujt i është bërë shtëpia dhe dikujt jo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky diskutim nuk duhet të bëhet në mbledhje, ta shohim si e ka dosjen, nëse dikush ka marrë dhe është në kushte të barabrata atëherë ke të drejtë, zotërisë i është kërkuar të heqë djalin që ka në USA, nga certifikata, nuk e lejon ligji këtë.Më mirë të thotë Këshilli do ta ndihmojmë për efekt të asaj që thotë Inxhinieri ,që dëmton dhe ta ndihmojmë em fondet tona, por duhet të jemi në rregull me ligjin.

Neresida Shindo: Pavarsisht se e ka djalin në USA, ai mund të mos ketë fuqi financaire për të rregulluar çatinë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Këshilli ka të drejtë të marrë vendim, nuk po i heq asnjë të drejtë Këshillit të Bashkisë, nëse doni mund të merrni vendim.Unë zbatoj vendimet e Këshillit, ky moment nuk ka nevojë për ndërhyrje, por vetëm duhet gjetur klauzola.

Ornildi Demollari: Po Marjana.

Marianthi Avarmi: Para se të largohet Kryetari, kam një kërkesë nga Pensionistët e fshatit Zvirinë, kërkojnë një ambjent për të kalaur kohën me njëri tjetrin.Faleminderit!

Server Xhuti: Nuk e di sa dakord do jemi, por të lemë rrogat si Këshill.

Ornildi Demollari: Pse jo.

Yllson Ibrahimllari:Këto çetat vullnetare duhet të marrin fund dhe sidmos kur vijnë nga e djathta, ne jemi këtu për të zbatuar ligjin, ka hapësira ligjore? Ajde ta bëjmë, për një zonjë të nderaur që jeton në Angli prej disa vitesh dhe merr Ndihmë Ekonomike ka një çështje në Prokurori, doni të bëheni çështje? Nëse do miratojmë diçka jashtë ligjit do shkojmë në Gjykatë.Ka hapësira ligjore, vullneti është.Kryetar nuk kam mbaruar unë mos u largo, nuk kam ezauraur Titij e Nderit.

Ornildi Demollari: Yllson vazhdo, pastaj tja japim fjalën qyetarit.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, i kam bërë një propozim Komisionit të Këshillit të bashkisë, në datën 28.03.2024, pas pak kokësh vjen një vit, me ndihmën dhe arsyetimin e shumë personaliteteve dhe Këshilltarë të krahut tjetër politik, janë arritur 14 firma, nuk po hyj me detaje me emra, e ka këtë të drejtë Komisioni, dy nga Komisionet statuore që ka Këshilli Bashkiak, një ndër ta, është dhe Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve ndërkohë kemi miratuar një rregullore, që për mua le për të dëshiruar, Kryetari në pesë mbledhje para, ka deklaruar që ajo rregullore, duhet rishikuar.Kemi një rregullore të miratuar, pavarshisht që një kompentencë që i jepet Këshillit Bashkiak, ja delegojmë te ky Komisionin Konsultativ i Titujve të Nderit, nuk kam aszgjë personale që e drejton këtë Komision Kryetari, por të kesh një Komision Konsultativ në Këshill dhe të kesh treçerekun e addministratës në këtë Komision Konsultativ i Titujve të Nderit, më duket pak një ngërç Juridik, 14 firma i kisha marrë, znj e nderuar të përulem si Infermiere, por duhet ta lëshosh këtë Komision të Këshillit Bashkiak sepse je e njëanshme, je Kryetare e Shoqatës të Veteranve dhe Dëshmoreve të luftës, Maliqi nuk ka vetëm Dëshmorë lufte, unë fatmirësisht i kam të dyja atributet dhe me Dëshmorët e luftës dhe me ata që i bënë Dëshmorë pas lufte.Ky Komision nuk u mblodh asnjëhere dhe nuk e dimë kush është Sekretari dhe kush është Kryetari, Kryetar unë besoj që ky Këshill Bashkiak të gjejë fonde të gjejë mundësitë, të marrësh dhjetë personalitete, si Jahollari, Profesorë, Dekanë mundësisht, mblidhet ai Komision njëherë në katër muaj ose katër herë në vit, i pagujmë nga fondet tona, po njerës që kanë lindur në vitet 95-96, pavarsisht Fakulteteve nuk besoj se të dinë raporetet e mira të luftës, pas luftës, unë besoj që kjo që kemi filluar kërkon një përgjigje, unë besoj se deti në datën 28.03.2025 ju do më jepni një përgjigje për Titujt, miratohen, nuk miratohen, i plotësojnë kriteret.Kur unë o dorzoj shkresat Sekretar në seancë të hapur të Këshillit Bashkiak, kjo automatikish merr formën e protokollimit, mezi e marr protokollin me znj.Rudina dhe thuhet pastaj që nuk ka dokumenta! Unë nuk harroj për këto raste.E para e punës ishte që këta janë njërës që e meritojnë dhe nuk po i hyj asnjërit për ta dsikutuar vendimi është i juaji, problemi është për ta çliruar këtë mentalitet këtu nga ngjyra njëshe.Problemi tjetër që mbetet për tu diskutuar, ajde ti japim dorën njëri tjetrit edhe të kenë vërtet vlera ata që do i japim, ta rregullojmë atë rregullore, të vijë ky Komiosni, zgjidhni kë të doni, Komisioni juaj është Komision Konsultativ, vendimet për miratimin e Titujve i marr Këshilli, Bashkia ka dy Tituj që i jep vetë, Kryetari ka dy Tituj dhe Këshill ka dy Tituj të vetë, unë kam kërkuar Tituj që jepen nga Këshilli Bashkiak.Ligji i ri, keni Rregulloren e firmosur nga

znj,Nikolla, keni ligjin e ri të firmosur nga Presidenti aktual z.Begaj 2023, me propozimet që vini i referoheni ligjit të vjetër edhe keni vendosur së fundmi dhe ligji ne ri.Unë besoj që të gjithë emerat e propozuar nga ju dhe ne, janë emra që i bëjnë nder Bashkisë Maliq, kjo është diçka honarifike, ne nuk paguajmë gjë, unë besoj se tani ka ardhur koha për ti dhënë një hapsirë tjetër edhe Opozitës dhe duhet të pranoni që Opozita pavarsisht sasisë, është një etintet dhe jo gjithmonë sasia përcakton cilësinë, kam dëgjuar që një pjesë janë Muslimanë, nuk kam asnjë vërretje unë, nuk e di a është Platori këtu?Do ju thoja diçka, kur e pyetën Abelin në Parajasë dhe i thanë çfarë do që të ndrojmë na dhimbja, nga vuajtjet, a ka kthim pas, në fund tha i lutem Zotit që së paku nuk më bëri Kain dhe unë po them ju lutem ju të lini pak hapsirë më shumë dhe jo vetëm për Komunistët në këtë Bashki.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Yllson! Kryetar po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do isha dakord me shumicën e atyre që tha Doktori, përjashto këtë të fundit, në konceptin tim, mund ta kem dhe gabim, nuk dua ti heq asnjë presje asaj çfarë ka nevojë rregullorja për dhënin e Titujve të Nderit, duhet ndryshuar dhe duhet përmirësuar, do isha shumë dakord që pjesë e kësaj rregullore, apo kësaj vendimarrje të jetë përfshirja në të e emrave të spikatur, Historianë, Profesorë të cilët besoj na japin mend të gjithve për dhënien e një titulli, do ishte shumë pozitive, në shumicën e rasteve atje te Komisioni që e drejtoj vetë, ka probleme në dhënien e mendimeve, pasi jo çdo kush mund të jetë i ditur apo të japë mendje për të gjitha fushat, kështu ne duhet të afrojmë rreth vetës, njerës më të ditur për të bërë punë më të mirë, po mos e pamë kështu, nuk do bëjmë punë asnjëherë dhe do isha shumë dakord, të kemi personalitete në këtë Komision edhe ndoshta duke i paguar me një pagesë honorifike.

Yllson Ibrahimllari: Z.Ceka ka shprehur dashamirësinë për të qenë pranë bashkisë, me që keni Palafitet, Rektori i Universitetit të Arteve të Bukura z.Erald Bakalli, kemi diskutuar, ka qenë iniciativa dhe e zonjës që keni këtu Brisilda Gjikondi dhe ajo ka biseduar dhe me juve për të bërë diçka, nuk ju mungon asgjë të bëni çfarë doni dhe nga Rektorait i Universitetit të Arteve as nga Akademikët.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ndoshta dhe nga Bashkim Jahollari si Profesor dmth ka emra, në këtë linjë e kisha, patjetër dhënia e Titujve të Nderit për emra të spikatur na bën nder të gjithve, nuk jam marrë dhe nuk do merrem me emra, atë çka ne duhet ta preçizojmë pak edhe ndoshta te kriteret kur duhet ti japim dikujt Qyetar Nderi dhe kur Mirënjoha e Bashkisë dhe dhënien e Titujve të Nderit mos e bëjmë sikur japim certifikata që nuka kanë vlerë, në këtë prizëm do doja mirëkuptimin e të gjithve, të jemi jo të kursyer për figurat, le të japim tituj se kanë kontribuar për bashkinë dhe nga zona jonë dhe kanë kontribuar në zona të tjera, por na kanë përfaqësuar denjësisht, në këtë linjë e kam, nuk duhet ta përzijmë me grupet e Këshlltarve të majtë e të djathtë, apo me pjesë fetare.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar!

Faslli Zholi: Kam një ankesë nga qytetarët e fshatit Zvirënë për Ujësjellsin, ke një inforamcion për këtë? Kam dhe një problem për Qendrën Shëndetësore të Libonikut, hapësira është shumë e vogël.Kam ngitur si shqetësim vendosjen e ndiçuesve te rruga e Drithasit Poshtë.Për sa i përket Korritës, është një lagje që nuk ndriçim fare, më kanë thënë që duhen disa shtylla dhe kam dhe diçka tjetër atje ku jetoj, me the që do e shoh rrugën e panë, ju kam thënë për 150 m Tubo ta mbyllim atë kanal se hidhen mbeturina dhe kam diçka për Legalizimet. Kam ankesa nga fsahti Sheqeras, i kanë shkuar dikujt për matje dhe nuk i japin përgjigje për Legalizmin, të kenë kujdes sepse njerzit mërziten kështu, pse ka dallime në Legalizm.Këto kisha, faleminderit!

Albina Xhejo: Kam dhe unë një shqetësim për fshatin Zvirinë, në lidhje me fushën e Sportit, nuk është dhe aq e përshtashme, më shumë futen bagëtitë, njërrethim.Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Zvirina është i vetmi fshat që nuk ka patur Ujësjellës, atje nuk punojnë pompat, Vreshatsi merr ujë nga Zvirina dhe Zvirina nuk kaj ujë për vete, ne kur kemi bërë asfaltin kemi futur dhe tubot për ujin brenda për Ujësjellsin, për momentin mendojmë të nxjerim disa çezma publike në Zvirinë.Në lidhje me fushën e Sportit ke të drejtë, është një fushë e mirë, në lidhje me Legalzimet ne jemi bërë pjesë, pas kalimit të Akt-marrveshjes në Këshillin e Bashkisë dhe kemi rënë dakord që në fshatrat që do hyjmë, do hyjmë për të gjitha Legalizimet, kemi filluar me disa fshatra, Sheqeras, Vreshtas, Podgorie, nuk mund të gjenden gjithë nerzit se mund të jenë jashtë, por gjithë lista që ne kemi dhe nëse kemi probleme të këtij lloji, ju them që do mbyllen të gjitha dhe duke qenë se ne jemi bërë pjesë e punës, kemi dhe ne përgjegjësi, nuk mund të ecet të bëjmë politkë me Legalzimet, në lidhje me kanalin e hapur e mbajta shënim, do e shohim, ajo kërkon një investim, rruga e Drithasit, kemi fituar një projket me FSHZH, ku ata do na japin gjithë bazën materiale të këtij projketi, ndirçues, pemë, pllaka trotuari, bordura dhe ne do bëjmë punën, jemi në fazën e prokurimit, ata e kanë bërë pjesën e tyre, sot kemi filluar me mbjelljen e pemeve, do mbjellim pemë në të dy krahët, do i japim ndriçim nga Liboniku deri afër urës të Dunavecit, do të ketë një kosrsi biçikletash, do të ketë një trotuar rreth 1.5 m, besoj do bëhet diçka e mirë, do ketë rreth 150 ndirçues, do ketë reth 200 pemë, do ketë ndarje të rrugës autombilistke nga truotuari me kona, them se do bëhet diçka e mirë, në Bregas, ndoshta mund të jetë lagjia në drejtim të shkollës, sot fillojmë një rrugë brenda fshatit, do futim në projektin që do bëjmë tani dhe një truotuar, nga qendra e fshatit në drejtim të shkollës, do ketë dhe ndriçim, ajo do i shërbejë dhe shkollës që fëmijët mos ecin në rrugë, spese ka rrezik, por do i shërbejë për ndriçim dhe lagjes në anën tjetër.Nuk e di a ju përgjigja të gjithave?

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar! Kemi diçka tjetër? Raportin e Performancës të Këshillit është e nevojshme ta lexoj? Dëgjojmë dhe qyetarin tjetër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI